



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 40.2 nen.c) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale 03/L-040, Ligjit i tatimit në pronën e palujtëshme në Kosovë nr.03/L-204, Udhëzimeve administrative nr. 3/2011 Për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatim paguesit dhe Udhëzimit Administrativ nr. 4/2011 Për përcaktimin e vlerës së pronës së palujtëshme dhe standardet e vlerësimit, nenit 40 paragrafi 40.2 nën c) të Statutit të Komunës së Klinës, Rregullores komunale mbi tatimin në pronë, me kërkesën e Drejtorisë së Financave Ekonomi dhe Zhvillim 05Nr. 430-4142 dt.28.09.2016, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IX të radhës për vitin 2016, të mbajtur më 31.10.2016, mori këtë:

V E N D I M
P Ë R

Konfirmimin e gjendjes së njëjtë të shkallës tatimore të pronës së paluajtshme për vitin 2017

- I. Konfirmohet gjendja e njëjtë vjetore e shkallës tatimore të pronës së paluajtshme për vitin 2017.
- II. Shkallët tatimore mbasin të njëjta si në vitin 2016 ku janë të përcaktuara me Rregulloren komunale për caktimin e tatimit në pronën e paluajtshme nr.01-434-3472/07.
- III. Shkalla e njëjtë tatimore vlen dhe zbatohet gjatë tërë vitit 2017 përderisa me ligj, Udhëzim administrativ apo rregullore të veçantë të ndryshohen.
- IV. Mos ndryshimi i shkallës tatimore për tatimin në pronë për vitin 2017 bazohet në kriteret e vlerësimit të bërë nga:
 - Zyra Komunale e tatimit në pronë,
 - Komisioni Komunal i vlerësimit të paluajtshmërive,
 - Anketimi i qytetarëve,
 - Shkresat e subjekteve që merren me shitjen e materialit ndërtimor,
 - Shkresat e subjekteve që merren me ndërtimin e ndërtesave, si dhe
 - Kostoja e jetesës së qytetarëve.
- V. Ky Vendim do jetë pjesë e Rregullores mbi tatimin në pronë e cila është në fuqi.
- VI. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL.

Më këtë vendim të njoftohet: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave Ekonomi dhe Zhvillim, një për Zyrën e Informimit dhe Shërbimin për Punë të Kuvendit dhe një për Arkivin e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01.Nr. 06-4527 2016
Klinë, më 04.11. 2016

